



—REPUBLICA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
SEKTORI I EMERGJENCAVE CIVILE DHE STREHIMIT

Nr 3695 prot.

Gramsh, më 25/09/2023

NJOFTIM

Në zbatim të ligjit Nr.22/2018 “Për strehimin social”, Vkm Nr.384, date 12.6.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, Vkm Nr.459, date 3.7.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti shtetit për subvencionimin e qirasë ose e uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministries përgjegjëse për strehimin”, Vkm Nr.362, datë 29.5.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lire, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, si dhe ligjit nr.139/2015, date 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” ju bëjmë me dije qytetarëve të cilët kanë rregjistruar kërkesat e tyre për t’u shpallur fitues në një nga programet e strehimit që ofron bashkia Gramsh se :

Nga data 1.10.2023 deri në datën 20.11.2023 pranë zyrës Emergjencave Civile dhe Strehimit duhen të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm për fazën e dytë të aplikimit si më poshtë:

1. Lista e dokumentave që duhet të dorëzohen:

Nr.	Lloji i dokumentit	X
1	Kopje e ID	
2	Çertifikatë familjare (nxirret nga zyra e shërbimeve)	
3	Deklarata e vërtetësisë së informacionit, të lidhur me kërkesën e strehimit	
4	Deklaratë e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve /dokumentave në lidhje me aplikimin	
5	Vetëdeklarim nëse individi/familja I përket komunitetit Rom, Egjiptian, LGBTI	
6	Kontratë qiraje	
7	Numër llogarie	
8	Vërtetim vendbanimi pranë njësisë administrative përkatëse	
9	Vërtetim për pagesën e ndihmës ekonomike	
10	Vërtetim për pagesën e aftësisë së kufizuar	
11	Vërtetim për pagesën e papunësisë	
12	Vërtetim nga tatimet dhe sigurimet shoqërore për derdhjen e kontributeve për të vetpunësuarit	
13	Vërtetim nga zyra e punësimit nëse është rregjistruar si punëkërkues	

14	Vendim i gjykatës që i lë në ngarkim fëmijën për çiftet e divorcuara	
15	Vërtetim nga përmbartimi për pensionin ushqimor që përfiton femija kur prindërit janë të divorcuar	
16	Libreza për statusin e jetimit	
17	Pasqyra financiare për vitin kalendarik të shkuar për të vetëpunësuarit.Ekstrakt historik QKB	
18	Vërtetim për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes (ASHK)	
19	Vërteim për sipërfaqen banesës,me sipërfaqe nën normat e strehimit (ASHK)	
20	Vërtetim për pronat ,për familjet që kanë ndryshuar vendbanimin për efekt punësimi	
21	Vërtetim për kategorinë vajzë-nënë (çertifikatë familjare	
22	Vërtetim i lëshuar nga kategoritë përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin	
23	Vërtetim për dhunat e dhunës në familje	
24	Vërtetim për familjet e punonjësve të rënë në krye të familjes	
25	Vërtetim për personat që kanë statusin: “emigrant”,”punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”	
26	Vërtetim i të ardhurave neto të familjes	

2. Ky njoftim afishohet në faqen zyrtare të bashkisë Gramsh dhe në stendën e njoftimeve në katin e I të bashkisë.
3. Dokumentacioni duhet dorëzuar nga datat 1.10.2023-20.11.2023 pranë zyrës së Emergjencave Civile dhe Strehimit.

KRYETARI

Besion AJAZI

